



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**



**KOMUNA E LIPJANIT**  
**OPŠTINA LIPLJAN**  
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

Në bazë të nenit 12, 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit Administrativ nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë si dhe nenit 20 par. 20.1,33 dhe 34 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28. 02. 2018, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryesuesit të Kuvendit miratoi këtë:

**V E N D I M**  
**PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

**Neni 1**

Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

**Neni 2**

Kryesuesi i Kuvendit është Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Neni 3**

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mandat 4 vjeçar

**Neni 4**

Për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa emërohen si vijon:

1. Daut Azemi, Kryesues i Komitetit
2. Hyra Bytyqi, LDK
3. Lumturije Bytyqi-Hasani, PDK
4. Albulena Kelmendi, VV
5. Ukë Kryeziu, AAK
6. Afrim Miftari, AKR
7. Fehmi Rexhepi PAI

**Neni 5**

Komiteti për Politikë dhe Financa në pajtim me dispozitat e nenit 52 par.52.2 ka detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, Planin vjetor të prokurimit, Rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

**Neni 6**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 020-12876  
Lipjan, më 01. 03. 2018

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Daut Azemi**

